



Shkurt 2014

Zëri i Grave Kosovare

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Bashkangjituni!

Protesta "Jemi me ju"

8 Mars, 12:00, Marshimi fillon te shesi Zahir Pajazit, Prishtinë

Mbledhja e RrGGK për Planin Strategjik 2015/2018

10 Mars, 11:00-15:00 Hotel Prishtina

Në këtë numër

Një Miliardë në Këmbë për t'i dhënë Fund Dhunës ndaj Grave.....2

Hendifer Organizon Trajtime rreth Kancerit.....2

Anëtarët e RrGGK-së krijojnë Manualet e Politikave.....3

Shoqata Iniciativa e Grave ndihmon vajzat nga Opoja të Avokojnë.....3

Anëtarët Takohen për Mbledhjen e Rregullt.....4

 [Faqja në Facebook](#)

 [Lista e dërgesave të E-Buletinit](#)

Rivendosja e Fotove të të Pagjeturve

Me 8 Mars 2014, në Ditën Ndërkombëtare të Gruas, me iniciativën e shoqatës "Thirrjet e Nënave" [RrGGK](#) organizon protestë në përkrahje të nënave, grave dhe motrave e bijave të të pagjeturve, me moton: Jemi me ju.

Para një viti, fotografitë e të pagjeturve u hoqën nga rrethojat e Kuvendit të Kosovës me premtimin se do punohet obelisku për të pagjeturit. Ai premtim nuk u realizua. Plot 15 vjet po na mashtrojnë e neglizhojnë përderisa kriminelët po sillen të lire dhe ata pak kriminelë që janë dënuar po ju ulen dënimet. Mungon drejtësia për mijëra të vrarë, të dhunuar dhe të zhdukur. Do kthejmë fotografitë aty ku ishin se çështja për të pagjeturit nuk është zgjidhë akoma", shprehet Nesrete Kumnova, udhëheqëse e Shoqatës "Thirrjet e Nënave".

RrGGK dhe shoqata "Thirrjet e Nënave" fton qytetarët që me 8 Mars 2014 të bashkangjiten në Sheshin "Zahir Pajaziti" në ora 11:30, prej nga në orën 12:00 do të fillojë marshimi drejt Kuvendit të Kosovës, ku do të rivendosen fotografitë e të pagjeturve në rrethojat e Kuvendit.



RrGGK dhe shoqata "Thirrjet e Nënave" fton qytetarët që me 8 Mars 2014 të bashkangjiten në Sheshin "Zahir Pajaziti" në ora 11:30

Një Miliardë në Këmbë për t'i Dhënë Fund Dhunës ndaj Grave

One Billion Rising (Një Miliardë në Këmbë) ka mbledhur gra e burra të protestojnë duke vallëzuar e të ngriten, në një organizim në ambient të hapur te platoja afër Grant Hotel në Prishtinë.

Më 14 Shkurt, burra dhe gra në Kosovë u ngritën dhe vallëzuan duke bërë thirrje për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave.

Pjesë e këtij organizimi ishte vallëzimi tradicional i One Billion Rising. OJQ Artpolis po ashtu ka performuar shfaqjen "Drejtësi për Gratë" (që përshkruan raste të dhunës qoftë në famije apo në forma tjera që kanë përjetuar shumë gra dhe vajza).

"Kjo është mënyra më e mirë për të protestuar dhe ngritur zërin tonë", tha një participante. Me vullnetin e saj, këtij aktiviteti iu bashkangjiti edhe Presidentja Jahjaga me stafin e saj.

Onë Billion Rising në Kosovë është organizuar nga një koalicion i orgnaizatave dhe individë (Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës,

Artpolis, Alter Habitus, Odal Haliti dhe Bleona Foniqi) dhe është mbështetur nga Kvinna till Kvinna dhe UNDP.

One Billion Rising (Një Miliardë në Këmbë) është një fushatë globale për t'i dhënë fund dhunës kundër grave, për t'u ngritur për drejtësi dhe promovuar barazinë gjinore.

Ka filluar në vitin 2012 si pjesë e lëvizjes V-Day. One Billion Rising (Një Miliardë në Këmbë) dhe V-day janë fushata që i ka filluar dramaturgia Eve Ensler, krijuesja e dramës së njohur "Monologjet e Vaginës" (The Vagina Monologues), që kanë vënë në pah statistikën se një në tri gra në planet dhunohen apo përjetojnë dhunë në familje gjatë jetës së tyre. Në vitin 2012, kampanja One Billion Rising (Një Miliardë në Këmbë) arriti kulmin si kampanja më e madhe globale ndonjëherë për t'i dhënë fund dhunës kundër grave me mijëra evente të mbajtura në më shumë se 190 shtete.

Në vitin 2014 One Billion Rising (Një Miliardë në Këmbë) është mbajtur në 207 shtete.

Hendifer Organizon Trajnime rreth Kancerit

Numri i grave i rrezikuar nga kanceri i gjirit po rritet çdo ditë e më shumë. Sidomos në zonat rurale ku njerëzit nuk janë aq të informuar për rëndësinë e zbulimit të hershëm dhe vizitat e rregullta te mjeku.

Për këtë arsye OJQ Hendifer ka organizuar trajnime për kancerin e gjirit dhe qafës së mitrës në fshatra të ndryshme të Ferizajit.

Deri më tani kanë marrë pjesë 205 gra në këto trajnime.

Numri i grave të interesuara për të marrë pjesë në këto trajnime është shumë i madh. Shtatë fshatra të komunës së Ferizajit (Jezerc, Cërnilë, Zllatar, Koshare etj.) kanë dërguar kërkesa me shkrim Hendiferit për të organizuar këto trajnime edhe në fshatrat e tyre.

Gjatë trajnimit gratë kanë mundësi të bëjnë pyetje për gjendjen e tyre shëndetsore dhe shqetësimet e tyre. Gratë të cilat ishin të shqetësuar që kanë ndonjë gjëndërr të rrezikshme, doktoresha u bëri egzaminime aty për aty, si dhe u tregoi grave si të egzaminonjë vetën për kancerin e gjirit në shtëpi.

"Shumica e grave pjesëmarrëse pas trajnimit kanë vizituar doktorin dhe kanë bërë analiza" tha Fazile Bungu drejtoresha Ekzekutive nga Hendifer. "Fatkeqësisht ne kemi pasur dy gra që janë diagnostifikuar me kancer në qafën e mitrës, por e kanë zbuluar me kohë dhe tani janë duke u mjekuar dhe jeta e tyre është jashtë rrezikut."



Pjesëmarrësit në Onë Billion Rising bëjnë thirrje për ti dhënë fund dhunës ndaj grave. 14 Shkurt Prishtinë



Dr. Shpresa Tafashaku duke ligëruar për kancerin e gjirit në fshatin Dremjak.

Anëtarët e RrGGK-së krijojnë Manualet e Politikave

Bazuar në kërkesat e anëtareve, më 19 Shkurt, RrGGK organizoi punëtorinë e parë interaive të këtij viti, që u përqëndrua se si të freskojë apo të krijojë Manualin e Politikave.

Rreth 30 anëtare, përfshirë dhe vajza, u mbledhën në Hotel Prishtina, disa prej tyre me laptopat e tyre dhe të tjerat me Manualet e Politikave me vete, të mësojnë më shumë për këtë temë. Elmaze Gashi udhëheqi këtë punëtori, duke u sqaruar anëtareve rëndësinë e të paturit Manual të Politikave.

Duke përdorur Manualin e Politikave të RrGGK-së si shembull, ajo shpjegoi çdo artikull me radhë se si duhet të shkruhet dhe si anëtarët mund ta adoptojnë atë në organizatat e tyre.

Anëtarët kuptuan se gjithçka që është shkruar në Manualin e politikave është e bazuar në ligjet e Republikës së Kosovës dhe pse duhet të rifreskohet kur ligjet ndërrojnë ose hyn në fuqi, si dhe kur ndodhin ndryshime të rëndësishme në kuadër të organizatave të tyre. Manualet e forta politike bëjnë organizatat transparente dhe më të forta, tha ajo.

Më vonë anëtarët u ndanë në tre grupe: organizatat të cilat nuk kanë manual të politikave; organizatat të cilat kanë manual të politikave por nuk e kanë rifreskuar për një kohë të gjatë; dhe organizatat të cilat kanë manual të politikave të rifreskuar por shprehën dëshirë ta krahasojnë me manualin e RrGGK-së.

Të gjitha grupet punuan për më shumë se tre orë në manualet e tyre. Ato që patën laptopët me veti bënë ndryshimet aty për aty ndërsa të tjerat morën shenime. Elmaze Gashi dhe stafi i RrGGK-së ndihuan të gjitha grupet, duke u përgjigjur pyetjeve që ato kishin.

Anëtarët e RrGGK-së që kanë nevojë më shumë të punojnë në manualin e politikave të tyre, do të vazhdojnë të punojnë dhe do ta dërgojnë dokumentin te RrGGK për rishikim dhe komente. Në fund anëtarët e RrGGK-së do të përpiqen të rifreskojnë manualet e politikave të tyre, drejt përmirësimit të zbatimit të tyre me Kodin e Etikës së RrGGK-së

Anëtarët ishin shumë të motivuara sepse punëtorja e shoqëruar me udhëzime të vazhdueshme do t'u siguroj atyre një manual të politikave, i gatshëm për ta përdorur deri në fund të marsit.

“Jam shumë falendëruese që RrGGK ka ofruar këtë punëtori pa pagesë. Unë nuk do të kisha pasur mundësi të marrë pjesë në një punëtori të tillë” - tha një anëtare e RrGGK-së participante në punëtori.

RrGGK do të vazhdoj të ofroj punëtori për organizatat anëtare bazuar në planin e zhvillimit të kapaciteteve të anëtareve për vitin 2014.

RrGGK po ashtu ka filluar të ofroj mentorim individual për anëtarët, duke vizituar organizatat dhe duke ofruar asistencë drejt forcimit të organizatave të tyre.

Shoqata Iniciativa e Grave Ndhmon Vajzat nga Opoja të Avokojnë

Shoqata Iniciativa e Grave nga Dragashi së bashku me zyrtaren komunale për barazi gjinore, znj. Lindita Kozmaqi-Piraj, organizuan një takim mes Kryetarit të Komunës së Dragashit z.Salim Jonuzaj dhe një grupi të vajzave nga Opoja.

Vajzat gjatë takimit me kryetarin paraqitën dy kërkesa me shkrim: Mbështetje financiare për vazhdimin e kursit të rrobaqepësisë edhe për dy muaj, si dhe ndërmjetësmimin e drejtëpërdrejtë të Kryetarit në punësimin e tyre në fabrikën e cila së shpejti do të hapet.

Kryetari aty përbushi kërkesën e parë për mbështetje të kursit, kurse për ndërmjetësim për punësim u dakorduan të kordinojnë aktivitetet në mes shoqërisë civile, insitucioneve dhe pronarit të fabrikës.

Si dhe me qëllim të zhdukjes së analfabetizimit të femrës në komunën e Dragashit, u dakorduan që brenda këtij viti të fillojnë me mësim jo të rregullt. Kryetari poashtu premtioji partictim të buxhetit komunal.

Do të vazhdojë të përkrah vajzat që të arrijnë qëllimin e tyre”, tha Xhejrane Lokaj nga Iniciativa e Grave



Elmaze Gashi spjejon anëtareve të RrGGK-së për rëndësinë e manualit të politikave 19 Shkurt Prishtinë

Anëtarët Takohen për Mbledhjen e Rregullt

Takimi filloi duke rikujtuar trajnimin e Shqipe Malushit që mbajti për anëtarët në Durrës, e cila thoshte që gjithmonë duhet t'i mendojmë gjërat pozitive që i kemi në jetë, në mënyrë që t'i largojmë negativet.

Igballë Rogova, Drejtoreshë Ekzekutive e RrGGK, pasi mirëpriti të gjitha 70 pjesëmarrëset, foli për mundësinë që Shqipe Malushi të vijë në Kosovë për 3 muaj për të vizituar organizatat anëtare në zyrat e tyre. Në mënyrë që të bëhet një planifikim sa më i mirë, u kërkua nga anëtarët të dërgojnë një kërkesë me nevojat që ato kanë për trajnimet që organizon Shqipe Malushi.

Anëtarët u informuan më detajisht për vizitën që i'u bë Znj. Mimoza Kusari – Lila në zyrën e saj në Kuvendin Komunal të Gjakovës, nga një delegacion i përbërë prej anëtareve të Bordit dhe stafit të RrGGK. Ato uruan Znj. Kusari – Lila për fitoren dhe diskutuan, e u dhanë ide të ndryshme nga të dy palët për fuqizimin e grave në Gjakovë.

Mimoza Paçuku, Koordinatore e Fondit të Grave të Kosovës (FDG) në RrGGK, prezantoi vlerësimet që janë përgaditur për secilën organizatë përfutuese në FDG (për më shumë detaje i keni të bashkangjitura në e-mail).

Në vazhdim, Igballë Rogova theksoi rëndësinë e përgjegjësisë së përfutimit të granteve dhe nënshkrimit të kontratës. Secila organizatë që merr grant ka përgjegjësi para Rrjetit, para donatorëve, dhe para komunitetit ku vepron. Ajo theksoi që në të ardhmen duhet të kemi më shumë kujdes për përgjegjësinë, imazhin dhe për keqpërdorime, pasi që qëllimi i FDG nuk është vetëm të ofroj grante, por edhe t'ju ndihmojë organizatave në ngritjen e kapaciteteve të tyre për të ardhmen. Gjithashtu u diskutua çështja e organizatave që kanë biznese e që aplikojnë në FDG. Meqenëse FDG duhet të fokusohet tek përkrahja e projekteve avokuese (avokim, ndryshim të politikave etj.), FDG nuk duhet të marrë kahje të përkrahjes së bizneseve. Deri tani, një pjesë e organizatave përfutuese kanë qenë në fushën e artizanateve, bujqësisë, dhe punë dore. Pasi që brenda Planit Strategjik të RrGGK 2011-2014 njëri nga programet është Fuqizimi Ekonomik, FDG ka vazhduar të përkrahë këto projekte gjatë vitit 2013.

Të gjitha organizatat që kanë biznese, poashtu edhe të pranishmet në sallë u informuan për krijimin e G7, një grup prej 7 grave afariste të fuqishme. Ky grup, përkrahur nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhe Ambasada Amerikane, ka krijuar Odën Ekonomike të Grave si dhe janë në fazat e fundit të krijimit të Rrjetit Afarist të Grave për biznese.

Andaj, u sugjerua që programi mbi Fuqizimin Ekonomik, brenda Planit Strategjik të RrGGK, të mos fokusohet në përkrahjen direkte të bizneseve, por në avokimin për të drejtat e tyre. RrGGK do të bashkëpunoj me Rrjetin e Grave Afariste i cili do t'i përkrahë drejtpërdrejtë këto organizata. Të gjitha anëtarët e pranishme unanimisht u pajtuan që ky

program të ndryshohet me sugjerimet e dhëna. Gjithashtu u vendos që FDG të fokusohet në përkrahjen e projekteve avokuese gjatë viteve në vijim.

Ndër të tjera anëtarët u informuan që në takimin e ardhshëm në muajin mars, RrGGK së bashku me anëtarët, do të punojnë në krijimin e Planit Strategjik të RrGGK 2015-2018. U kërkua nga anëtarët që paraprakisht të interesohen për nevojat dhe kërkesat e komunitetit ku ato veprojnë.

Gjatë takimit, anëtarët vendosën të shprehin përkrahjen e tyre për kërkesat e studenteve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", pasi që konsiderojnë që këto kërkesa janë të drejta dhe se UP nuk duhet të jetë i politizuar, ai duhet tu takojë vetëm studentëve. Kumtesa për media e përgaditur gjatë takimit, u dërgua menjëherë tek mediat (gjeni të bashkangjitur kumtesën).

RrGGK ndau kohën të përgëzoj dhe të falenderoj Lina Andeer, përfaqësuesja për Kvinna till Kvinna (KtK) në Kosovë, për besimin e saj në Rrjet dhe për përkrahjen e vazhdueshme nga ajo dhe KtK. Lina nuk ishte e pranishme në takim, mirëpo të gjitha anëtarët shprehën kënaqësinë që ato kanë pasur të punojnë me të. Lina do të përfundoj punën e saj në KtK në fund të muajit mars, ndërsa KTK do të përfundojë misionin në Kosovë në fund të vitit 2014.



Mimoza Paçuku, Koordinatore e Fondit të Grave të Kosovës (FDG) në RrGGK, prezantoi vlerësimet FDG, 3 Shkurt Prishtinë



Rreth 70 pjesëmarrës ishin present në Mbledhjen e Rregullt të RrGGK-së 3 Shkurt. Hotel Prishtina

WOMEN'S NETWORK • RRJETI I GRUPEVE TË GRAV

